

Nr. _____ Prot.
23.03.2018

Elbasan me

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

1. Autoriteti kontraktor: **SHOQERIA "UKE" SHA.**

adresa: **Lagja "Brigada 17 Sulmuese", ish Knvikti i Shkolles "Onufri", Elbasan,
NIPT L43121201L**

nr.tel: **+355 54 240 755**

email: **ukelbasan@gmail.com**

Për: **Operatorin Ekonomik "UEVI-2015" shpk**

Adresa: *Elbasan, Lagja "Dyli Haxhire", rruga "Kadri Hoxha", NSHU, zona kadastrale
nr.2346, pasuria nr.3/83, kati 1,*
NIPT – L52904201S

Procedura e prokurimit: **"TENDER I HAPUR" (SHERBIME).**

Numri i referencës së procedurës: **REF-43601-02-02-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Sherbimi i sigurimit dhe i ruajtjes fizike te objekteve te shoqerise "U.K.Elbasan" sha, me roje fizike dhe sistem alarmi, per vitin 2018" - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj".**

Fondi limit i Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj – **26.638.741 (njëzete e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzetë e një) lekë pa tvsh.**

Fondi limit i shërbimit ditor – **72.998,75 (shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë presje shtatëdhjetë e pesë) lekë (me te cilin janë krahasuar ofertat).**

Burimi i financimit: **Te ardhurat e veta te shoqerise "UKE" sha (shoqeri tregtare me kapital shtetëror, institucion jo buxhetor).**

Publikime të mëparshme: Buletini i APP-se Nr.6 date **12.02.2018 (faqe 85-86)**, ku eshte botuar **Formulari i Njoftimit te Kontrates.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët.**

Njoftojme se kane qene pjesemarres ne procedure **3 (tre) operatore ekonomik** ofertues me vlerat perkatese te ofertes te ofruara, si me poshte:

1. Operatori ekonomik - **"BAHITI-G" shpk + "NAZERI 2000" shpk**, me nr.NIPT – **K83410201O + K31422029Q**, me vleren e ofertes pa tvsh, per çmimin e shërbimit njesi (ne 1 dite) të korrigjuar - **69.621,85 lekë (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëzetë e një presje tetëdhjetë e pesë) lekë.**

2. Operatori ekonomik - **"KUMRIA 1" shpk**, me nr.NIPT – **K32712210C**, me vleren e ofertes pa tvsh, per çmimin e shërbimit njesi (ne 1 dite) të paraqitur - **69.608,81 leke lekë (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetë presje tetëdhjetë e një) lekë.**

3. Operatori ekonomik - **"UEVI-2015" shpk**, me nr.NIPT – **L52904201S**, me vleren e

ofertes pa tvsh, per çmimin e shërbimit njesi (ne 1 dite) të korrigjuar - **70.115,08 lekë (shtatëdhjetë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë presje zero tetë) lekë.**

Operatore te s'kualifikuar – **Jane skualifikuar 2 (dy) operator ekonomik:**

1. Oferta e operatorit ekonomik “BAHITI-G” shpk + “NAZERI 2000” shpk, eshte refuzuar sepse:

Oferta e këtij operatori ekonomik eshte paraqitur per shumen **69.606,66 lekë**. Kjo oferte është korrigjuar nga KVO dhe nga korrigjimi, vlere e sakte rezulton per shumen **69.621,85 lekë** me nje difference prej 15,19 leke me shume nga vlere e ofertes se paraqitur, ose oferta e paraqitur ka nje korrigjim prej 0.02% me e vogel nga vlere e ofertes ne fakt se rezultuar nga korrigjimi. Por shuma totale e korrigjimit aritmetikor eshte me e vogel se 2% e vleres se ofertes se paraqitur. Më datë 13.03.2018, nga KVO-ja i është kërkuar këtij operatori ekonomik, të pranojë vlerën e ofertës së korrigjuar. Më datë 13.03.2018, ky operator është përgjigjur në sistem: *nuk jemi dakort dhe nuk pranojme korrigjimin e ofertes*. Sa më sipër, në mbështetje të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, pika 4, oferta e operatorit ekonomik “BAHITI-G” shpk + “NAZERI 2000” shpk, refuzohet nga KVO.

2. Operatori ekonomik: “KUMRIA 1” shpk, eshte skualifikuar sepse:

Ky operator ekonomik nuk provon se ka paguar taksat per automjetet në pronësi apo në përdorim të shoqërisë. Kjo bie në kundërshtim me Dokumentat e Tenderit, Kriteret e Veçanta për Kualifikim, pika 2.4.6. Për njërin nga 2 mjetet e paraqitura, mjetin me targë AA826MY “Autoveturë”, në pronësi të operatorit ekonomik “KUMRIA 1” shpk, rezulton se nga Polica e Sigurimit, sigurimi i mjetit është për periudhën 03.02.2017 – 02.02.2018. Pra, më datë 02.02.2018 (dita e zhvillimit te tenderit), sigurimi i mjetit ka skaduar dhe nuk është paguar siguracioni për vitin 2018. Ndërsa nga Çertifikata e Kontrollit Teknik si dhe nga Mandat-Pagesa e Taksës vjetore të mjeteve, rezulton se taksat janë paguar për periudhën deri më 07.02.2018. Pra në ditën e hapjes së tenderit (28.02.2018), operatori ekonomik nuk rezulton të ketë paguar taksat për këtë automjet, çka përbën shkak skualifikimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik: **“UEVI-2015” shpk,** me adrese: *Elbasan, Lagjja “Dyli Haxhire”, rruga “Kadri Hoxha”, NSHU, zona kadastrale nr.2346, pasuria nr.3/83, kati 1,* se oferta e korrigjuar dhe e pranuar me vleren e shërbimit për njesi (ne 1 dite) - **70.115,08 lekë (shtatëdhjetë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë presje zero tetë) lekë pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Shoqërisë “UKE” sha,** ne zyren e Sekretarise, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet sikurse parashikohet nga Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 15.03.2018 (ne sistem).

Ankesa nuk jane paraqitur nga asnje operator ekonomik.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ADMINISTRATORI
Besmir PRIFTI**

